



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 666/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Rrezarta Avdyli-Nuha, kandidate për anëtar të Kuvendin Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Rrezarta Avdyli-Nuha, kandidate për anëtar të Kuvendin Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Rrezarta Avdyli-Nuha, kandidate për anëtar të Kuvendin Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime në të cilën pretendon se në vendvotimin 2206E/04D në Godanc sipas të dhënave të vëzhguesve ju është bërë e padrejt nga komisionarët së bashku me anëtarët e tjerë. Parashtruesja e apelit thekson se vëzhguesit i kanë shënuar 12 vota ndërsa në FPR janë 4 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore duke gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin

zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe nga rinumërimi i fletëvotimeve për Kutin e Votimit 2206E/04D, është konstatuar se në këtë vendvotim kandidatja me nr. Rendor 12 Rrezarta Avdyli Nuha nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, i posedon 4 vota.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtrueses së apelit pas hetimit të bërë nga PZAP-i janë vërtetuar se të njëjtat nuk qëndrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 666/2017 më datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.